

INSTITUTI I
STUDIMEVE POLITIKE



INSTITUTE FOR
POLITICAL STUDIES

STANDARDET E DEKRIMINALIZIMIT DHE ZGJEDHJET E BRENDSHME NË PARTITË POLITIKE

ZGJEDHJET 2021:

PROMOVIMI I LLOGARIDHËNIES SË ZYRTARËVE TË ZGJEDHUR



National Endowment
for Democracy

RAPORTI ËSHTË REALIZUAR NGA STAFI I ISP NË KUADËR TË PROJEKTIT
PROMOVIMI I LLOGARIDHËNIES SË ZYRTARËVE TË ZGJEDHUR
MBËSHTETUR NGA NED (NATIONAL ENDOWMENT FOR DEMOCRACY).

Mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe të ISP.
Ato nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit.

Përgatitur nga ekipi monitorues i ISP

Drejtues i Projektit
Afrim KRASNIQI

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

Web: www.isp.com.al

Email: contactaips@isp.com.al dhe contactaips@gmail.com

Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies

Adresa: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

HYRJE

Pas ndryshimit të Kushtetutës dhe reformës zgjedhore partitë politike janë fokusuar në përgatitjet për procesin e zgjedhjeve parlamentare të dekretuara më 25 prill 2021. Zgjedhjet do të kenë ndryshime në formulën e konkurrimit (ndalohen koalicionet e hapura parazgjedhore, pragu elektoral ulet në 1%, dy të tretat e listave proporcionale do të jenë të hapura), të cilat kanë ndikim direkt edhe në ndërtimin e strategjive elektorale. Në kushtet kur teorikisht ekziston mundësia që listat e hapura të krijojnë konkurrencë brenda partive politike, këto të fundit bënë përpjekje për të krijuar mekanizma të brendshëm atraktivë për prurje të reja dhe për të siguruar përfaqësim që maksimizon votat përtej votave tradicionale militante. Spektri politik paraelektoral ka ndryshuar: tri parti të reja politike i janë shtuar garës elektorale, dy prej të cilave të iniciuar nga deputetë të opozitës aktuale parlamentare. PS në qeveri ka mbështetjen e një numri të madh partish të vogla politike mbështetëse të saj edhe më 2017 e 2019, PD në opozitë ka programuar daljen me një listë të përbashkët me disa prej partive të djathta tradicionale, dy lista të tjera konkurruese mund të formohen nga LSI si dhe disa prej partive të reja. Prurjet e reja dhe ndryshimet nuk ndikojnë në natyrën e pandryshuar prej 2004 të sistemit partiak në Shqipëri, dy plus 1.

Periudha shtator-dhjetor 2020 u shoqërua me procese të brendshme zgjedhore në disa nga partitë kryesore politike. Këto procese sollën risi dhe problematika, rezultatet finale të të cilave do të shihen në fazën kur partitë të bëjnë publike listën e kandidatëve zyrtarë në zgjedhje. Pavarësisht rezultatit final, në tërësi disa procese shënuan risi dhe sollën ndryshim nga tradita e emërimeve vertikale në partitë politike. Pesë vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit 138/2015, të njohur si ligji i dekriminalizimit, Shqipëria politike vijon të përballet me sfidën e zbatimit integral të tij. Zgjedhjet e vitit 2021 janë moment i rëndësishëm për testimin e maturimit të partive politike dhe reflektimit të tyre ndaj standardeve të dekriminalizimit.

Instituti i Studimeve Politike (ISP), me mbështetjen e NED (National Endowment for Democracy) është duke zbatuar nismën *“Promovimi i llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur: zgjedhjet 2021”*, e cila konsiston në monitorimin e proceseve zgjedhore në partitë politike dhe në atë të zgjedhjes së kandidatëve për zgjedhjet parlamentare 2021. Pjesë e angazhimit të ISP janë raportet periodike, forumet e hapura, informimi dhe sensibilizimi publik, rekomandime për përmirësime në legjislacion dhe vendimmarrje, etj. Ky raport përmbledh periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2020¹.

¹ *Gjetjet dhe qëndrimet e pasqyruara në këtë raport dhe në deklarata të ndryshme publike të ISP lidhur me projektin, nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e NED, por të ISP dhe ekspertëve të tij.*

GJETJET KRYESORE TË PERIUdhËS PARA-ELEKTORALE

- *Ndryshimet kushtetuese 2020 dhe ndryshimet në Kodin Zgjedhor diktuan ndryshime të brendshme në skenën organizative dhe vendimmarrëse të partive politike. Partitë kryesore tentojnë votat e zgjedhësve të pavendosur, ndaj ato e kanë të domosdoshme zgjerimin e rrethit dhe grupeve përfaqësuese si dhe përmirësimin e imazhit të tyre publik.*
- *Nën presionin publik për rritjen e cilësisë së përfaqësimit politik në zgjedhjet parlamentare 2021, partitë kryesore politike nxitën praktika të reja dhe eksperimentale në procese të brendshme zgjedhore për kandidatët për deputetë. PD aplikoi sistemin e propozimeve dhe votimit paraprak nga anëtarësia për përzgjedhjen e një liste potenciale kandidatësh, PS aplikoi konkurrimin individual për 20% të listës shumëemërore të saj në zgjedhjet e vitit 2021. Të dy nismat janë risi, aplikohen për herë të parë dhe pritet të kenë ndikim pozitiv në integritetin e listave të kandidatëve.*
- *Ambasada e SHBA ka pasur ndikim pozitiv në disa deklarime publike kundër kandidimit në zgjedhje të individëve me rekorde kriminale, duke theksuar se kryetarët e partive duhet të sigurojnë integritet dhe saktësi në deklarin e personave që kërkojnë të marrin mandat nën grupimin partiak. Rol aktiv në rritjen e presionit pozitiv për jetësimin e standardeve të dekriminalizimit kanë luajtur edhe ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta (AMVU), Misioni i OSBE në Shqipëri, Delegacioni i BE-së, etj. Një tryezë në dhjetor 2020 mbështetur nga OSBE dhe AMVU bashkoi në një debat profesional mbi aktualitetin e procesit të dekriminalizimit dhe sfidat 2021 të gjitha institucionet përgjegjëse (Prokurori, KQZ, partitë kryesore politike, shoqërinë civile, etj).*
- *Partitë kryesore kanë shprehur vullnet politik për të respektuar standardet etike dhe të dekriminalizimit, si dhe kanë premtuar të aplikojnë rregulla dhe mekanizma paraprake verifikimi të kandidatëve. PS, PD dhe LSI deklaruan në dhjetor 2020 se mirëpresin edhe idenë e publikimit të listës paraprake të kandidatëve, si verifikimin e hershëm nga ana e Prokurorisë.*
- *Disa ish deputetë dhe politikanë që kanë qenë subjekte të penalizuara në kuadër të zbatimit të ligjit të dekriminalizimit, janë bërë aktiv duke u shfaqur në jetën politike dhe aktivitete paraelectorale të partive të ndryshme. Asnjë parti nuk ka refuzuar publikisht riaktivizimin e tyre, asnjë parti nuk ka deklaruar ende ndonjë vendim që largon nga strukturat individët që janë larguar për shkak të dekriminalizimit.*
- *Partitë kanë krijuar strukturat etike dhe të integritetit, por funksioni i tyre është formal dhe ende pa ndikim në vendimmarrjen e tyre. Drejtuesit e komisioneve të etikës në PS*

dhe PD nuk u përzgjedhën si drejtues të procesit të seleksionimit të kandidatëve në parti, - një tregues kritik i formalitetit të këtyre strukturave.

- *Parti të veçanta vijojnë të mbajnë në struktura drejtuese politikanë që bëjnë pjesë në listën e zezë të Departamentit Amerikan të Shtetit. Rasti më tipik është ai i ish kryetarit të bashkisë Durrës. Disa ish subjekte të vettingut, të shkarkuar për korrupsion, kanë shprehur ambicien për tu bërë pjesë e listave elektorale më 2021. Legjislacioni e lejon, por premtimi i partive kryesore politike ka qenë për refuzimin e tyre. Në një rast PD deklaroi publikisht refuzimin për një subjekt të vettingut, por deri tani nuk ka pasur raste të tjera distancimi.*
- *Individë me rekorde kriminale ose pjesë e listës së zezë amerikane vijojnë të jenë aktiv edhe në partitë e vogla politike. Njëri prej tyre mori drejtimin formal të PSD, partia e dytë tradicionale e të majtës në 30 vitet e fundit. Të tjerë janë përfshirë në fraksione lokale të partive duke pasur indirekt mbështetje dhe sponsorizimi kryesisht nga partia në pushtet.*
- *Gjatë 4 muajve të fundit nuk ka pasur raste të reja denoncimi dhe as raste të njohura të largimit të zyrtarëve të lartë për shkak të dekriminalizimit. Disa procese hetimore ndaj subjekteve të dekriminalizimit, përfshirë dy raste të kryetarëve të bashkive, vijojnë të jenë nën shqyrtim nga Prokuroria.*
- *Partitë përgjegjëse nuk kanë kryer asnjë veprim distancues ndaj asnjë prej zyrtarëve partiakë dhe shtetërore të përfshirë në skandalet e zgjedhjeve në Dibër apo në Durrës e Shijak. Mbështetja ndaj tyre dhe promovimi për zgjedhjet 2021 mbetet tregues kritik dhe vjen në kundërshtim me parimet e dekriminalizimit dhe premtimet mbi standardet e integritetit.*
- *Partitë politike nuk kanë publikuar ende CV e plota dhe formularët e deklarimit të anëtarëve të tyre të kryesive dhe stafëve drejtuese. Ky nuk është detyrim ligjor, por kërkesë e vazhdueshme e medias dhe e shoqërisë civile, të cilën partitë parimisht e kanë pranuar, por ende nuk e kanë zbatuar.*
- *Ligjërimi mbi dekriminalizimin është linear: të gjitha partitë deklarojnë se duan të respektojnë dekriminalizimin. Nga ana tjetër, secila palë politike ende nuk ka prezantuar një strategji të qartë dhe të besueshme për jetësimin konkret dhe real të dekriminalizimit në të gjithë procesin zgjedhor, në zgjedhjen e kandidatëve, strukturës, por edhe në emërimin e komisionerëve në zgjedhje.*
- *Media dhe grupet e shoqërisë civile kanë meritën e presionit pozitiv ndaj partive politike, duke denoncuar çdo rast të dekriminalizimit dhe duke mbajtur vazhdimisht qëndrime kritike ndaj rasteve kur partitë refuzojnë distancimin prej subjekteve të dekriminalizimit ose kur promovojnë figura me rekorde negative penale.*

PROCESET ZGJEDHORE BRENDA PARTIVE POLITIKE

Vendimmarrjet mbi postet e larta politike, ku vend të rëndësishëm zënë kandidatët për deputetë, tradicionalisht kanë qenë përgjegjësi statusore e kryesive të partive politike. Gjatë tranzicionit ka pasur raste kur vendimet e kryesisë janë ndarë me struktura të tjera vendimmarrëse, si Asambleja Kombëtare/Këshilli Kombëtar, por gjithashtu ka pasur raste të shumta kur vendimmarrja është personalizuar nga kryetari i partisë dhe stafi i tij i afërt. Në zgjedhjet e fundit parlamentare (2017) lista e kandidatëve për deputetë në PD nuk u miratua në kryesi apo në Këshill, por nga kryetari, ndërkohë që në PS gjithashtu vendimmarrja nuk ishte statusore, duke buruar nga kryetari ose nga grupe koordinimi të emëruara sipas qarqeve. Në partitë e tjera politike nuk ekzistojnë mekanizma realë konsultues dhe vendimmarrës përveç kryetarit të partisë dhe stafit të tij të afërt.

Në zgjedhjet lokale 2019, të cilat u zhvilluan pa pjesëmarrjen e opozitës, PS aplikoi gjithashtu praktika të imponimit nga lart të kandidaturave. Në dy raste (Shkodër e Vorë), vendimi rezultoi i gabuar, pasi të dy kryetarët rezultuan se kanë pasur dënime penale dhe për pasojë, u bënë objekt shkarkimi nga ligji 138/2015, ligji i dekriminalizimit. Fakti se individë me të shkuar penale arritën lehtësisht të shfaqin e të marrin poste të rëndësishme politike edhe më 2019, ishte tregues kritik për dështimin e partive politike përgjegjëse, për të reflektuar nga gabimet e zgjedhjeve 2013, 2015, 2017, si dhe të injorimit prej tyre të standardeve të dekriminalizimit dhe të integritetit në politikë.

- Gjatë viteve 2013-2019 në grupin parlamentar të Partisë Socialiste bënë pjesë edhe disa individë, të cilët rezultuan se kanë të dhëna të papajtueshme me ligjin 138/2015, të njohur si ligji i dekriminalizimit. Ata humbën mandatin parlamentar, por kosto më e madhe ishte ajo që ata i sollën vendit dhe institucioneve, duke krijuar perceptimin se individë me rekorde kriminale ndikojnë e drejtojnë në institucione politike, përfshirë Kuvendi i RSH. Pas 2016 PS u ndodh nën presionin në rritje për përgjegjësitë e saj në përzgjedhjen dhe mbështetjen e individëve të tillë, ndaj në vitet pasuese ajo kërkoi forma e instrumente të reja, për të mënjanuar skandalet me rekordet e kandidatëve dhe përgjegjësitë politike që burojnë prej tyre. Presioni u rrit më shumë edhe pas dy rasteve të vitit 2019. Në këtë drejtim, gjatë viteve të fundit PS miratoi një paketë rregullash dhe procedurash konsultimesh dhe vendimmarrjesh, të cilat formalisht e bëjnë atë partinë më të “kompletuar” me akte procedurale të brendshme.
- Pas vendimit të opozitës për të dorëzuar kolektivisht mandatet parlamentare në shkurt 2019, rreth 40 vende vakante u zunë nga individë që vinin kryesisht nga partitë aleate dhe ishin pjesë e listës proporcionale të PD e LSI në zgjedhjet e vitit 2017. Performanca e tyre publike dhe parlamentare ishte në nivelet më kritike në raport me çdo legjislature të tranzicionit. Shumica e tyre demonstroi se nuk kishin aftësi minimale politike dhe as

njohuri institucionale, duke u bërë vazhdimisht pre e skandaleve për shkak të deklarimeve e sjelljes së tyre. Ekspertë të politikës dhe medias bënë përgjegjës për nivelin e tyre kritik jo individët vetë, të cilët për shkak të sistemit zgjedhor nuk ishin zgjedhur nga qytetarët, por liderit politikë që kanë preferuar dhe vendosur përzgjedhjen e tyre për përfaqësim parlamentar. Kritikën u shtuan akoma më shumë në kontrastin midis nivelit të deputetëve që ishin emëruar në lista në raport me nivelin e lartë të ish deputetëve, të cilët, për shkak të mendimeve kritike ndaj kryetarëve të partive, ishin mënjanuar nga listat e kandidatëve. Nën presionin publik të dyfishtë, PD shpalli më 2020 nismën e saj për të ndryshuar tërësisht mekanizmin dhe standardet e përzgjedhjes së kandidatëve për deputetë për zgjedhjet e vitit 2021.

Gjatë muajve të fundit dekriminalizimi dhe nevoja për kandidatë me integritet dhe me CV të pastër është promovuar ndjeshëm nga përfaqësi dhe institucione ndërkombëtare në Tiranë, të cilat krahasimisht me institucionet vendore, kanë pasur rol shumë më të madh në lobimin publik për zbatimin e standardeve të dekriminalizimit.

- Përmes një akti publik të paprecedentë, më 1 shtator 2020, sesioni politik nisi me letrën e ambasadores amerikane Yuri Kim drejtuar partive politike. Në këtë letër ambasada theksoi: *“Më 22 korrik ne theksuam publikisht se kryetarët e partive kanë përgjegjësi për kandidatët që kandidojnë nën logon e partive të tyre. Ndërsa partia juaj përgatitet për fushatën elektorale, ju, si kryetari i partisë, duhet të siguroni përputhshmëri me ligjin shqiptar. Ne i inkurajojmë të gjithë partitë politike, që kandidatët e zgjedhur të kenë kaluar procesin e vettingut dhe të respektojnë votën e shqiptarëve. Edhe pse individit ka përgjegjësi për fshehjen e historisë kriminale, kryetarët e partive duhet të sigurojnë integritet dhe saktësi në deklarin e personave që kërkojnë të marrin mandat nën grupimin partiak”.*
- Mesazhe të drejtpërdrejta për të njëjtën temë dhe problematikë adresuan edhe disa përfaqësi të tjera të rëndësishme në Tiranë, përfshirë delegacionin e BE dhe OSBE. Përfaqësi si ajo e Mbretërisë së Vendeve të Ulta u angazhuan në nxitjen e dialogut midis institucioneve dhe aktorëve politikë për jetësimin e standardeve të dekriminalizimit, me fokus zgjedhjet parlamentare të vitit 2021.
- Në dhjetor OSBE në bashkëpunim me ambasadën holandeze dhe Institutin e Studimeve Politike realizoi një tryezë debati me pjesëmarrjen e prokurorisë, KQZ, avokatit të Popullit, përfaqësuesve të lartë të tri partive kryesore, medias dhe shoqërisë civile. Fokusi i debatit lidhej me arritjet dhe sidomos sfidat për jetësimin integral të dekriminalizimit gjatë procesit zgjedhor të prillit 2021.

PROCESI VETËKANDIDUES NË PS: RISITË DHE PROBLEMATIKAT

Mbledhja më e rëndësishme e PS lidhur me standardet e integritetit dhe praktikat e brendshme rregullatore u mbajt në 8 tetor 2020. Mbledhja e Asamblesë Kombëtare miratoi 13 rregullore, midis të cilave rregullorret “Komisioni i Garancive Statutore dhe Etikës”, “Kodi i Etikës në Parti”, si dhe “Kodi i Zgjedhjeve në Parti”. PS nuk i bëri publike përmbajtjen e tyre dhe as nuk i ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, megjithatë stafi i ISP siguroi draftet e miratuara, të cilat kanë përmiresime të vogla ndaj të njëjtave akte që ishin në fuqi përpara kësaj mbledhjeje.

- Më 4 tetor PS langoi aplikacionin “vlerëso deputetin tënd”, sipas të cilës çdo anëtar dhe anëtare partie do të pyetet lidhur me deputetët dhe deputetet në qarkun e vet. Sipas PS, çdo anëtar dhe anëtare partie do të japë një vlerësim me pikë nga 1 tek 5, i bazuar në mbështetjen që ai\ajo ka dhënë. Këto vlerësime, sipas saj, do të ishin ndihmë për PS për të kuptuar nivelin e marrëdhënieve mes deputetëve dhe anëtarëve të partisë.
- Nisma u jetësua, por efekti publik ishte minimal. Në këto rrethana në dhjetor PS lancoi një nismë tjetër, për aplikimin e një praktike të re të vetë-kandidimit për deputet. PS deklaroi se do të pranonte aplikime përmes vidos të individëve që aspirojnë për tu bërë deputetë, dhe në fund të procesit prurjet nga kjo nismë do të përbëjnë rreth 20 vende në listën totale shumëemërore të PS. Procesi nisi në dhjetor dhe vijoi edhe gjatë janarit 2021. Sipas deklaramit zyrtar të PS platformës vetëkandidate të Partisë Socialiste, “Deputeti që duam” iu përgjigjën afro 1600 kandidatë për deputetë për zgjedhjet e 25 qershorit. PS organizoi disa faza trajnimi dhe selektimit për të arritur 57 kandidatë në fazën e dytë².
- Gjatë kësaj periudhe PS mori vendime të tjera organizative, kryesisht emërim koordinatorësh në zona elektorale apo emërim të drejtuesve në disa degë. Shumica e emërimeve u bënë në funksion të zgjedhjeve dhe pa marrë në konsideratë praktikat statusore të zgjedhjeve në degët lokale. Zhvillimi i proceseve testuese për kandidatët për deputetë dhe praktika e emërimeve vertikale janë dy zhvillime të kundërta, të cilat në dy

² Platforma ka qene e hapur për të gjithë, kanë qenë 1600 kandidatura dhe të gjithë kanë qenë të lirë të ofrohen dhe të japin videon dhe cv e tyre, dhe letrën e motivimit për tu bërë pjesë e kësaj gare. Aty ka nga të gjithë qarqet e Shqipërisë dhe jashtë saj. Do të bëhet seleksionimi në bazë të kriterëve dhe brenda kësaj jave do të zgjidhen 100 më të mirë dhe më pas do të ketë një procedurë tjetër ku do të fillojë trajnimi i tyre online nga ekspertët më të mirë të komunikimit publik dhe atij politik, në mënyrë që përzgjedhja që do të bëhet në janar të dalin realisht ata që e meritojnë të bëhen pjesë e PS. Se do jenë 20, 18 apo 23 ky nuk është një fiks i përcaktuar, por kush do të ketë performancën më të mirë. Në listat përfundimtare do të jenë forumet dhe drejtuesve politik do të merret vendim për të përcaktuar më pas se si do të pozicionohen këto kandidatë”, tha Peza. <https://shqiptarja.com/lajm/peza-ne-report-tv-deklaratat-e-metes-pengese-per-integrimin-e-shqiperise-ne-be-nga-deputeti-qe-duam-mund-te-dalin-me-shume-se-20-kandidate>

rastet nuk janë ende garantuese se produkti do të sjellë standarde më të larta të cilësisë së kandidatëve dhe jetësim real të dekriminalizimit.

- PS ka refuzuar kërkesat e medias dhe shoqërisë civile për të mbajtur një qëndrim të qartë distancues ndaj individëve të akuzuar me rekorde kriminale apo në listën e zezë të DASH. Kryeministri mori disa herë në mbrojtje ish kryetrarin e bashkisë Durrës, pavarësisht shqetësimeve të shprehura nga pala amerikane dhe mesazhit negativ ndaj klimës e standardeve të dekriminalizimit. PS gjithashtu nuk u distancua nga asnjë prej individëve të saj, zyrtarë dhe politikanë, të përfshirë në skandalin e zgjedhjeve në Dibër apo në Durrës, çështje që është ngritur në disa raporte ndërkombëtare dhe në media perëndimore.
- Qëndrimi i PS ndaj individëve që kanë refuzuar me rekorde kriminale ose penale, ka evoluar, nga mbështetja ndaj tyre (2004-2017) në distancim të plotë dhe trajtimin si problem personal të individëve përgjegjës (2018-2020). PS ka deklaruar disa herë se cdo individ me rekorde negative është përgjegjës për të dhënat e tij, CV e tij dhe pasojat në përballje me legjislacionin e dekriminalizimit. Ende nuk ka të dhëna se procesi i verifikimit të hershëm në këtë parti ka pasur efektivitet, por gjithashtu ende nuk ka rast konkret të përjashtimit nga gara e brendshme në parti të ndonjë individi me rekorde penale apo kriminale.
- Në aspektin demokratik PS aplikoi edhe votën e anëtarësisë për zgjedhjen e delegatëve për Kongresin e saj Kombëtar, si dhe jetësoi gjatë 2018-2019 një proces politik organizimi, me parimin, - cdo post drejtues në nivelin e mesëm dhe të lartë në bashki/zona zgjedhore do të jetë bashkëdrejtues në aspektin gjinor.

PROCESI ZGJEDHOR NË PD: RISITË DHE PROBLEMATIKAT

PD e prezantoi nismën e saj si praktikë të huazuar nga modeli i Partisë Konservatore në Britani të mbështetur edhe nga Instituti Republikan Amerikan në SHBA dhe CDU në Gjermani. Në javën e parë të muajit gusht 2020 Kryesia e PD njoftoi miratimin e ngritjes dhe përbërjes së Komisionit Vlerësues të Kandidatëve (KVK), dhe përcaktoi se procesi do të realizohej në tri faza: Identifikimi i kandidatëve të mundshme (25 Qershor – 31 Korrik 2020), seleksionimi i kandidatëve të mundshme (1 Gusht - 15 Shtator 2020), si dhe konsultimi i kandidatëve me anëtarësinë (15 Shtator – 30 Shtator 2020).

- Gjatë muajit gusht u raportua se janë propozuar më shumë se 6 mijë kandidatë, një pjesë e të cilëve ishin individë të propozuar nga anëtarësia pa marrë miratim paraprak nga vetë kandidatët e propozuar. Zgjedhjet e para u aplikuan në qarkun e Kukësit 23-24 shtator 2020 për të vijuar në qarqet e tjera. Vendimmarrje nga anëtarësia që sollën heqje kandidatësh nga lista pati edhe në Berat, Shkodër, Pogradec, Tiranë, etj. Në tërësi kontestimet ishin minimale dhe procesi rezultoi jo problematik, nisur edhe nga mënyra e ndërtimit të tij. Zgjedhësit (anëtarët) nuk mund të ndikonin në tërësi në listën e kandidatëve ose renditjen finale të tyre, por mund të eliminonin një ose më shumë kandidatë nëse kundër tij votohej me 20% të votave.
- PD zbatoi një formular të detajuar për secilin nga kandidatët, ku një pjesë e mirë të dhënave lidhen me të dhënat parandaluese të dekriminalizimit. Kjo praktikë është pozitive, gjithsesi nuk njihet ende mekanizmi që PD ka përdorur për të verifikuar të dhënat e deklaruara ndërkohë që sipas të dhënave të ISP ajo nuk ka adresuar asnjë kërkesë në Prokurori. Gjithsesi, një nga vendimet e rëndësishme të KVK ishte lista e Vlorës, në të cilën Komisioni përjashtoi që në fazën e parë ish deputetin Dashmir Tahiri, i cili është një prej deputetëve që ka humbur mandatin parlamentar për shkak të procesit të dekriminalizimit. KQZ ia hoqi mandatin e deputetit në dhjetor 2016, një vit pas jetësimit të procesit të dekriminalizimit, megjithatë Tahiri arriti të përfshihej në listën e kandidatëve të PD për deputet në zgjedhjet e vitit 2017. Vendimi i PD më 2020 për ta hequr nga lista si kandidat të papërshtatshëm ishte vendim kurajoz dhe mori mbështetje edhe nga zëra të rëndësishëm të shoqërisë civile.
- Pas fazës së dytë, KVK zhvilloi një proces të mbyllur vlerësimi të kandidatëve dhe hartoi listën finale të tyre. Në njoftimin e PD theksohej se Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturave (KVK) përfundoi vlerësimin e 3593 kandidatëve të propozuar, *në një listë përfundimtare prej 498 kandidatësh të certifikuar nga Komisioni* se përmbushin kriteret statusore për përfaqësimin politik të PD. Nga 498 kandidatët e konfirmuar nga anëtarësia dhe që plotësojnë kriteret statusore për përfaqësim politik, Komisioni ka vlerësuar që 299 kandidatë nga listat e secilës Degë dhe 27 kandidatë të listës kombëtare (në total 326), t'i propozohen organeve vendimmarrëse të Partisë për të qenë në listën finale të

përfaqësimit të PD në zgjedhje. PD njoftoi zyrtarisht se nga lista e kryesisë dhe grupit parlamentar të vitit 2017 janë konfirmuar 27 kandidatë dhe janë pjesë e një liste që u shtyhet aprovimi 13 ish deputetë, midis të cilëve edhe ish kryetari i PD (1995-1997) Tritan Shehu.

- Vendimi final i KVK u shoqërua me kritika dhe kontestime nga individ me ndikim në PD. Rasti “Gurakuqi” nxiti dyshime serioze mbi standardet e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies nga ana e KVK, si dhe mbi praktikën e vlerësimit të kandidatëve. Ky rast gjithashtu nxori në pah formalitetin e strukturës së Apelit në parti, ndaj edhe konflikti midis tij e ish Presidentit Nishani përfundoi në proces gjyqësor në sistemin e drejtësisë.
- Në tërësi, procesi në PD përbën risi dhe pati elementë pozitivë. Nga ana tjetër, duke qenë një eksperiment rezultoi problematik në disa drejtime. Komisioni (KVK) nuk bëri asnjë deklaratë zyrtare publike gjatë gjithë veprimtarisë së tij, por të dhënat e aktivitetit erdhën kryesisht përmes akteve konkrete në procesin zgjedhor, si dhe deklarimeve në formë intervistash apo komentesh të anëtarëve të tij në media. Në faqen zyrtare të PD nuk pati publikim të rregullores së funksionimit të komisionit, të mënyrës sesi ai vepron, mblidhet, merr vendime dhe gjykon ndaj pretendimeve apo animimeve, si dhe as për detyrimet apo përgjegjësitë ndaj organeve të tjera statusore në parti. Do të duhet të pritët vendimi final për listat për të kuptuar nëse ky proces rezultoi pozitiv apo formalitet në vendimmarrjen politike të PD lidhur me zgjedhjet e vitit 2021.
- Në nëntor PD i drejtoi një letër publike Prokurorit të Përgjithshëm³, ku shprehej zhgënjimi i saj në aktivitetin e prokurorisë lidhur me disa raste të dekriminalizimit, si dhe e akuzon institucionin për mungesë transparence dhe efektiviteti. Letra citon denoncimet ndaj kryetarit të bashkisë Vau i Dejës (10.10.2019) dhe Mallakastër, (8.1.2020), si dhe faktin se legjislacioni përcakton se hetimet duhen mbyllur brenda 3 muajve, ndërkohë që procesi ka zgjatur më shumë se një vit. Opozita kërkoi informacion të detajuar për të gjitha veprimet administrative që janë kryer deri në këtë moment për shqyrtimin e kërkesës për verifikimin e figurës së shtetasve M.B. dhe Q.I, si dhe informacion mbi fazën në të cilën ndodhet procesi i verifikimit dhe arsyet e vonësës 1 vjeçare.

³ <https://ëëë.neësomb.al/partia-demokratike-leter-kryeprokurorit-po-pengoni-dekriminalizimin-prej-1-viti-keni-bllokuar-verifikimin-e-2-kryebashkiakeve-te-mallakastres-dhe-vaut-te-dejes-226666>

PROCESET ZGJEDHORE NË PARTITË E TRETA: RISI E PROBLEMATIKA

Partitë e treta (LSI, partitë e vogla politike, partitë e reja politike) nuk kanë pasur procese të rëndësishme zgjedhore brenda tyre. Pjesa më e madhe e tyre nuk kanë struktura funksionale dhe nuk zhvillojnë zgjedhje periodike në parti, ndaj është e pamundur të identifikohen në standarde krahasuese dhe referuese me partitë e mëdha.

- Ndër partitë e tjera politike vetëm LSI zhvilloi një proces statusor zgjedhor për kryetarin e partisë. Fillimisht më 21 nëntor LSI zhvilloi zgjedhjet për kryetarin e LSI dhe delegatët në Konventën Kombëtare. Sipas njoftimit të saj zyrtar, LSI krijoi një aplikacion online për votimin e delegatëve. Aplikimi i votimit online përbën risi dhe është zbatuar vetëm pjesërisht nga PS në zgjedhjet e fundit të brendshme. LSI deklaroi se votimi online u bë në kushtet e COVID dhe pamundësisë për votim fizik të të gjithë anëtarëve. Zgjedhje e delegatëve do të shoqërohej me zhvillimin e Konventës Kombëtare Zgjedhore më 5 dhjetor. Në përfundim të procesit u njoftua se votuan 80% e 44 mijë anëtarëve, nga të cilët 28 mijë fizikisht dhe rreth 16 mijë online. Zgjedhjet konfirmuan në krye të LSI Monika Kryemadhi me 42 mijë vota pro nga 44 mijë anëtarë votues. Në dhjetor LSI njoftoi shtyrjen e Konventës Zgjedhore ku do të zgjidheshin strukturat e tjera drejtuese, kjo për shkak të gjendjes së pandemisë dhe ndalimit me ligj të aktiviteteve partiake.
- LSI ndërkohë ka bërë të ditur emra të veçantë si kandidatë në zgjedhjet parlamentare 2021, pa pasur një proces konkurrues, por duke u bazuar në 1-2 vendet kryesore të listës në qarqe. Në aspektin politik partitë, të cilat synojnë 1-2 mandate në qarqe e kanë të vështirë të zhvillojnë garë formale ndërkohë që emrat janë të paracaktuar. Në aspektin praktik të gjitha partitë e treta politike bazohen tek individ lokal dhe jo tek struktura lokale, ndaj për sa kohë individ është caktuar paraprakisht nuk merr vlerë partia dhe parimet e garës/konkurrencës.
- Të njëjtat praktika aplikohen edhe në partitë e tjera më të vogla. Asnjë parti nuk ka procese të brendshme konkurruese dhe as votim alternativ për kandidatët për deputetë. Ato synojnë të kontaktojnë individë të veçantë me ndikim lokal dhe e bazojnë suksesin ose dështimin e tyre në bilancin elektoral të këtij individ. Disa prej partive politike synuan dhe arritën të sigurojnë marrëveshje politike me PD ose partitë e tjera të mëdha, dhe ndaj nuk kanë listë kandidatësh zyrtarë.
- Procese konkurruese zgjedhore nuk pati as në partitë e reja politike të krijuara rishtas, pavarësisht se ato janë kritike të mënyrës sesi merren vendimet në partitë e mëdha politike.

- Asnjë nga partitë e treta/vogla politike nuk vënë në dyshim standardet e dekriminalizimit, por nga ana tjetër, asnjë prej tyre nuk ka ndërmarrë akte të dukshme publike të verifikimit të hershëm apo parandalimit të ambicieve nga individë me rekorde kriminale apo korruptive.
- PAA ishte ndër partitë e vetme që kërkoi informacion edhe nga ISP për të hartuar rregullat e brendshme etike, ndërsa partitë e reja politike kanë premtuar të aplikojnë standarde të reja, por ende nuk kanë miratuar akte dhe as struktura drejtuese.